



Visual Evidence for Victims

Të gjitha shërbimet janë falas dhe të fshehta

Jeni një viktimë e dhunës në familje?

Jeni një viktimë e krimit të urrejtjes?

Jeni një viktimë e dhunës seksuale?

Keni pësuar lëndime fizike apo ju është dëmtuar prona?

Nuk jeni gati ta raportoni krimin në polici? - Provat Vizuale për Viktimat (VEV) mund t'ju ndihmojë -

Shumë nga viktimat e një krimi të dhunshëm vendosin që të mos raportojnë në polici, sidoqoftë, një viktimë mund të pranojë që lëndimet e saj të regjistrohen nga një agjenci e sektorit vullnetar. Projekti VEV u ngrit për t'u mundësuar njerëzve që të regjistrojnë provat e një krimi me anën e një agjencie vullnetare, në mënyrë që viktimës të mos i duhet të shkojë në polici. Shumë agjenci në zonën tuaj kanë punonjës të cilët janë të përgatitur për përdorimin e kamerave të miratuara VEV për të regjistruar lëndimet ose dëmtimin e pronës.

- Lëndime fizike: shenja të mavijosura, prerje, gërvishitje, flokë të shkullur etj.
- Dëmtim i Pronës: Xhama të thyer të dritareve, derë e dëmtuar, parulla fyese në mure etj.

Ne mund të regjistrojmë prova fotografike në mënyrë që ju të keni prova për të ngritur padi në të ardhmen. Këto prova më pas mbahen të fshehta dhe të sigurta për t'u përdorur në të ardhmen. Provat mund të përdoren në gjykatën e krimeve ose në procese civile, nëse viktima vendos që të ngrejë padi. Përndryshe, ato mund të mbahen në një dosje (për një maksimum prej 6 vitesh), ose ju mund të zgjidhni që t'i asgjësoni fotografitë. Ju mund të përdorni ndihmën dhe informacionin për t'ju ndihmuar që të vendosni se çfarë doni të bëni.

Ju nuk do të detyroheni kurrë që të bëni regjistrimin e provave - ne do t'i bëjmë fotografitë vetëm me pëlqimin tuaj. Ne i trajtojmë të gjitha viktimat me dinjitet dhe mirëkuptim. Ne do të jemi të ndjeshëm dhe do të kuptojmë se lëndimi juaj mund të jetë i një natyre intime. Agjencitë VEV NUK DO t'i tregojnë askujt tjetër që ne kemi fotografitë tuaja. Nëse ju e keni raportuar krimin në polici, ju nuk keni nevojë që të përdorni shërbimin VEV. Ekzistojnë 34 agjenci në Anglinë Qendrore Perëndimore të cilat ofrojnë shërbimin VEV, për të mësuar më shumë, kontaktoni Mbështetjen e Viktimave në: **0121 544 4336**.

Ky projekt menaxhohet nga Mbështetja e Viktimave, për më shumë informacion, ju lutemi, kontaktoni Lucy George- 0121 543 1722.

Broshura është lëshuar nga:

(leaflet given out by)

(VEV leaflet – Albanian Translation, Oct 2007)